



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1139 Prot.

Ballsh, më 28.02.2022

VENDIM

NR. 13 DATË 28/02/2022

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 55, DATË 22.12.2020 "PËR MIRATIMIN E
VLERËS SË SHPRONËSIMIT TË QYTETARËVE DASHNOR MALASI DHE
VELEDIN MALASI NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTEVE TË BASHKISË
MALLAKASTËR"**

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar, të VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në republikën e Shqipërisë", të projektit "Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh", si dhe referuar shkresës nr. 18 prot., datë 06.01.2022, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 87 prot., datë 07.01.2022, të Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, të shkresës nr. 24/1 prot., datë 14.02.2022, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 339/1 prot., datë 15.02.2022, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Mallakastër, të procesverbaleve të vlerësimit të hartuara nga grupi i punës,

VENDOSI

1. Në pikën 1 të Vendimit nr. 55, datë 22.12.2020 "Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Dashnor Malasi dhe Veledin Malasi në kuadër të zbatimit të projekteve të Bashkisë Mallakastër", bëhen këto ndryshime:
Miratimin e vlerës paraprake të shpronësimit si më poshtë (referuar procesverbaleve të vlerësimit):
 - a. Z. Dashnor Adem Malasi- Vlera Totale e shpronësimit **188 800 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.**
 - b. Z. Veledin Adem Malasi - Vlera Totale e shpronësimit **200 600 (dyqind mijë e gjashtëqind) lekë**
2. Në pikën 3 të Vendimit nr. 55, datë 22.12.2020 "Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Dashnor Malasi dhe Veledin Malasi në kuadër të zbatimit të projekteve të Bashkisë Mallakastër", bëhen ky ndryshim:
Vlerësimi paraparak është kryer në bazë të shkresës nr. 24/1 prot., datë 14.02.2022, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Mallakastër administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 339/1 prot., datë 15.02.2022.

KRYETAR

Mbarime Isufaj